KISHA E
JEZU KRISHTIT
E SHENJTORËVE TË
DITËVE TË MËVONSHME

Regjistrimi në Seminar

Mundësitë për regjistrimin në seminar: 1) plotësojeni këtë formular ose 2) regjistrohuni në internet te seminary.lds.org/register.

Shënim: Studentët në programet me orë të lira mësimore duhet t'i përfshijnë orët e lira në programet e tyre shkollore.

Informacioni i Studentit Ju lutemi, shtypeni qartë.

Emri (emri, emri i mesit, mbiemri)		Emri i parapëlqyer	Gjuha e parapëlqyer
Data e lindjes (dita, muaji, viti)	Lagjja ose dega		Kunji ose distrikti
Gjinia ☐ Mashkull ☐ Femër	Feja ☐ SHDM ☐ Tjetër	Viti shkollor i vitit të ardhshëm	Frekuentimi i seminarit dhe i shkollës

Informacioni i Kontaktit Kryesor (Prindi ose Kujdestari)

Emri (emri, mbiemri)		Adresa e postës elektronike	
Adresa postare	Qyteti	Shteti ose krahina	Kodi postar / Shteti
Telefoni i shtëpisë	Telefoni celular	Telefoni i punës	
Numri i mesazheve në celular	Shteti i mesazheve në celular	Mundësia e parapëlqyer e kontaktit ☐ Shtëpi ☐ Punë ☐ Celular ☐ Mesazh në celular ☐ Mesazh elektronik ☐ Mos komunikoni me mua	

Informacioni i Kontaktit Dytësor (Prindi ose Kujdestari)

Emri (emri, mbiemri)		Adresa e postës elektronike	
Adresa postare	Qyteti	Shteti ose krahina	Kodi postar / Shteti
Telefoni i shtëpisë	Telefoni celular	Telefoni i punës	
Numri i mesazheve në celular	Shteti i mesazheve në celular	Mundësia e parapëlqyer e kontaktit ☐ Shtëpi ☐ Punë ☐ Celular ☐ Mesazh në celular ☐ Mesazh elektronik ☐ Mos komunikoni me mua	

Nënshkrimet Nënshkrimi i këtij formulari të regjistrimit nënkupton pranimin e marrëveshjes së mëposhtme nga ana juaj.

Studenti	Data
Prindi (ose kujdestari)	Data

Marrëveshja

Leja për të Marrë Pjesë në Seminar

Pjesëmarrja në seminar është një privilegj dhe ne ju mirëpresim. Ju dhe fëmija juaj (të quajtur në grup "ju") bini dakord dhe jepni leje që të merrni pjesë në diskutimet, veprimtaritë dhe orët mësimore të seminarit, duke përfshirë, nëse regjistroheni në seminarin me orë të lira, një orë mësimore gjatë ditës së shkollës. Ju bini dakord që do të pajtoheni me rregulloren e seminarit (duke përfshirë kërkesën e frekuentimit të rregullt, në kohën e duhur të orëve mësimore) dhe gjithashtu bini dakord që Seminaret dhe Institutet e Fesë, një sektor i Korporatës së Presidentit të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, dhe subjektet ligjore të lidhura me të (të quajtura në grup "ne") nuk janë përgjegjës për asnjë dëmtim që mund të rrjedhë nga mosarritja juaj për t'u pajtuar me këtë rregullore.

Rregullorja e Privatësisë së Informacionit të Studentit

Ju bini dakord që ne mund ta mbledhim dhe përpunojmë informacionin tuaj vetjak nga ky formular dhe nga dokumenti juaj i anëtarësisë (nëse jeni anëtar i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme) për qëllime që kanë lidhje me regjistrimin dhe pjesëmarrjen tuaj në seminar, dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve ose çështjeve që mund të shfaqen teksa jeni në seminar. Ju e kuptoni se informacioni juaj personal mund të transferohet te zyrat qendrore të Kishës në Shtetet e Bashkuara dhe ju pajtoheni me këtë transferim, nëse gjen zbatim. Informacioni juaj personal mund të ruhet për një kohë të pacaktuar si pjesë e një dokumenti të përhershëm historik të Kishës. Ne kurrë nuk do ta shesim informacionin tuaj. Ne përdorim masa teknike dhe organizative për ta mbrojtur informacionin vetjak që marrim, prej humbjes, keqpërdorimit e ndryshimit të paautorizuar dhe për ta mbrojtur fshehtësinë e tij.

Studimet dhe sondazhet kërkimore: Nëse ju kërkohet të merrni pjesë në një studim ose sondazh, ju e kuptoni se pjesëmarrja është tërësisht vullnetare dhe se mund të tërhiqeni në çdo çast. Çdo informacion vetjak që jepni si pjesë e një studimi kërkimor (për shembull, adresa e postës elektronike ose numri i telefonit celular) do të përdoret vetëm për qëllimin e kontaktimit rreth pjesëmarrjes suaj në studimet apo sondazhet e ardhshme. Ju mund ta hiqni autorizimin për marrjen e komunikimeve të tilla.

Lejimi për Përdorimin e Imazhit

Me raste, neve do të na duhet t'ju filmojmë ose regjistrojmë ju në lidhje me seminarin. Përdorime të mundshme përfshijnë, por nuk kufizohen

© 2013, 2019 by Intellectual Reserve, Inc. All rights reserved. 2/19. 2/19. ***Seminary Registration.*** Albanian. PD50048392 101

me këto: veprimtari të të mësuarit në largësi, trajnime të mësuesit dhe fotografi ose materiale filmike në librat e vitit shkollor, mbrëmje rreth vatrës, stenda lajmërimesh, faqe interneti apo media shoqërore. Për këtë qëllim, ju na caktoni dhe na jepni në mënyrë të pakthyeshme të drejtën dhe lejen për të përdorur dhe – pa kufizim në kohë, numër, gjuhë, gjeografi dhe/ose mjet komunikimi (duke përfshirë mjete komunikimi tashmë të panjohura dhe të së ardhmes) – riprodhuar, shpërndarë, paraqitur, kryer, krijuar vepra që rrjedhin nga ndonjë imazh ose regjistrim, apo për të dhënë leje për ndonjë imazh ose regjistrim tuajin që është bërë në lidhje me seminarin. Ju na autorizoni që ta përdorim ose regjistrojmë emrin, zërin, imazhin, pamjen dhe shfaqjen tuaj; t'ju intervistojmë dhe ta regjistrojmë intervistën tuaj dhe ta kopjojmë, riprodhojmë, përshtatim, redaktojmë dhe përmbledhim çdo regjistrim për përdorim sipas lirisë sonë të veprimit. Ju autorizoni riprodhimin, shitjen, të drejtën e autorit, shfaqjen, transmetimin, ruajtjen në pajisjet elektronike dhe/ose shpërndarjen e imazheve ose regjistrimeve pa kufizim, sipas lirisë sonë të veprimit. Me anë të kësaj ju na lironi prej asnjë dhe të gjitha detyrimeve nga një përdorim e publikim i tillë, dhe ju hiqni dorë nga çdo e drejtë shpërblimi për këdo nga të mësipërmet.

Rregullorja e Përdorimit të Internetit

Ne ju sigurojmë një numër burimesh elektronike për t'ju mundësuar pjesëmarrjen në seminar. Mund të vendosni a do t'i përdorni ose jo këto burime, por, nëse i përdorni, ju pranoni kushtet vijuese:

Kur futeni në internet duke përdorur godinat, pajisjet apo teknologjinë tonë me valë, ne mund të mbledhim informacion nga shfletuesi juaj i internetit. Ky informacion mund të përfshijë adresën tuaj IP [të Protokollit të Internetit], llojin e shfletuesit, sistemin operativ dhe gjuhën e parapëlqyer; ndonjë faqe interneti referuese që po vizitonit përpara se të hynit në faqen tonë; datën dhe orën e secilës vizitë dhe informacionin që kërkoni në faqet tona. Ne gjithashtu përdorim cookies [mesazhe për shfletuesin] dhe heqim GIF-et për ta mbledhur informacionin në internet. Ju mund ta ndryshoni veçorinë e shfletuesit tuaj të internetit për ta ndaluar pranimin e cookie-ve ose për t'ju njoftuar përpara se ta pranoni një cookie nga faqet që vizitoni. Megjithatë, nëse e konfiguroni veçorinë tuaj të shfletuesit të internetit që të mos i pranojë cookie-t ose t'i heqë GIF-et, ju mund të mos jeni në gjendje t'i përdorni disa nga pjesët ose funksionet e faqeve tona.

Faqet e internetit, programet kompjuterike, përmbajtja, shpërndarësit, teknologjitë dhe materialet e tjera që ne përdorim për të dërguar programe të seminarit ("Seminary Tools" ["Mjetet e Seminarit"]), zotërohen si pronë ose u jepen leje e vihen në veprim nga ne. Ne mund të vëzhgojmë të gjitha komunikimet (postën elektronike, mesazhet në celular [sms], mjetet e komunikimit shoqëror dhe kështu me radhë) që përdoren ose që ndodhen brenda Seminary Tools [Mjeteve të Seminarit] për përmbajtje të papërshtatshme ose të paligjshme dhe mund t'ua dërgojmë ato udhëheqësve kishtarë ose zyrtarëve të forcave ligjore, nëse nevojitet për t'i mbrojtur studentët dhe interesat e Kishës. Ju pajtoheni me këtë vëzhgim dhe dërgim. Edhe pse ne mund t'i vëzhgojmë disa komunikime, ne nuk mund t'i vëzhgojmë të gjitha komunikimet. Komunikimet elektronike nuk janë të sigurta. Ne nuk garantojmë që ju nuk do të ekspozoheni ndaj mesazheve, materialeve, viruseve të padëshiruara ose dëmtuesve të tjerë. Mesazhet që përfshijnë përmbajtje të papërshtatshme, mund të fshihen pa ju lajmëruar dhe mund të mos u dërgohen marrësve të parashikuar. Ju bini dakord që nuk do të dërgoni ose ridërgoni ndonjë mesazh që është i pahijshëm, përgojues, i paligjshëm ose plot urrejtje, apo që cenon ose dhunon të drejtat e të tjerëve. Seminary Tools [Mjetet e Seminarit] mund të përdoren vetëm për komunikim me studentë të tjerë, mësues dhe udhëheqës kishtarë lidhur me tema e ngjarje që lidhen me ungjillin. Ju nuk mund të shkarkoni, rishpërndani ose publikoni (për shembull, në YouTube ose Facebook) asnjë material teksti, imazhi, zanor ose filmik nga Seminary Tools [Mjetet e Seminarit].

Ne nuk jemi përgjegjës për asnjë dëmtim (përfshirë humbjen e të dhënave) të shkaktuar nga përdorimi juaj, apo nga paaftësia juaj për të përdorur Seminary Tools [Mjetet e Seminarit], ose ndonjë material apo mesazh që jepet aty ose nga përdorues të tjerë apo faqe të tjera të lidhura me të. Seminary tools [Mjetet e seminarit] jepen "siç janë". Ne i mohojmë të gjitha garancitë e shprehura ose të nënkuptuara, përfshirë garancitë e titullit, tregtimit dhe përshtatjes për një qëllim të caktuar. Ne nuk garantojmë që funksionimi i mjeteve të seminarit do të jetë i pandërprerë ose pa gabime, që defektet do të ndreqen ose që çdo faqe apo shpërndarës interneti, që i mundëson mjetet e seminarit, është pa viruse ose përbërës të tjerë të dëmshëm.

Të Ndryshme

Ju jeni përgjegjës për pajtimin me të gjitha ligjet dhe rregulloren në zonën tuaj, por kjo Marrëveshje drejtohet nga ligjet e Shtetit të Jutës në SHBA, pa u dhënë fuqi parimeve të konflikteve me ligjin. Çdo veprim ligjor, i ndërmarrë për ta zbatuar këtë Marrëveshje ose që lidhet me seminarin, do të ndërmerret në gjykatat shtetërore ose federale, të vendosura në kontenë e Solt-Lejkut të Jutës në SHBA dhe me anë të kësaj ju pajtoheni dhe i nënshtroheni juridiksionit personal të gjykatave të tilla. Nëse ndonjë nga normat e kësaj Marrëveshjeje është e paligjshme, e anuluar ose e pazbatueshme, si e tërë ose pjesërisht, normat e mbetura nuk do të ndikohen vetëm nëse ne përcaktojmë që norma e shfuqizuar ose e pazbatueshme është një pjesë thelbësore e Marrëveshjes, rast në të cilin ne, sipas lirisë sonë të plotë të veprimit, mund ta ndryshojmë Marrëveshjen.

Nëse keni pyetje apo shqetësime në lidhje me këtë Marrëveshje, ju lutemi dërgojini shqetësimet tuaja nëpërmjet postës elektronike te siregistration@ldschurch.org ose komunikoni me administratorin tuaj vendor të seminarit.

2/19. PD50048392 101